



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.624/22

GJYKATA KOMERCIALE-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Berisha dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.P.T “S... Sh.p.k” me seli në, të cilin e përfaqësuar sipas autorizimit Naim Spahiu avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr. 2865/19, të dates 18.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 10.11.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditësit N.P.T “S... Sh.p.k” me seli në, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr. 2865/19, të dates 18.05.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr. 2865/19, të dates 18.05.2021 është refuzuar kërkesëpadia e paditësit N.P.T “S... Sh.p.k” me seli në, si e pabazuar, dhe mbetet në fuqi aktvendimi me nr.01.3.2.2/11216,13732 i datës 22.10.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi e paditësit N.P.T “S... Sh.p.k” me seli në, ka ushtruar ankesë për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa dhe të ndryshohet në tërësi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë A.nr. 2865/19, të datës 18.05.2021, në atë formë që të aprovohet kërkesëpadinë e paditësit, dhe të anulohet vendimi i të paditurës vendimi nr. 01.3.2.2 / 11216, 13732 i datës 22.10.2019.

Paditura nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë e paditësit.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 i LPK-së, në drejtim të theksimeve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar, nr.01.3.2.2/11216,13732 i datës 22.10.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë N.P.T “S... Sh.p.k” me seli në, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-47046 i datës 16.09.2019 të ZBD Prishtinë si të pabazuar.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit, nr. 01.3.2.2/11216,13732 i datës 22.10.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, në seancën e shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar kërkespadin e paditësit, duke e lënë në fuqi aktvendimin e kontestuar.

Me arsyetim se e paditura ka konfirmuar rivlerësimin e Sektorit për pranimin qëndror për mallin lëndor të zhdoganuar me DUD-at kontestuese, duke konstatuar se ka aplikuar drejtë metodën e 6 të vlerësimit nenin 35 Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, ku si provë janë marrë të dhënat e disponueshme dhe vlera e transaksioneve të mallrave të ngjajshme të shitura për eksport në Kosovë DUD-i R-.../03.06.2019, dosja e vlerave. Po ashtu e paditura dokumentacionin përcjellës të mallit e ka konsideruar si provë të pamjaftueshme sepse paditësi nuk ka prezentuar kontratën e lidhur me eksportuesin, si dhe transferet bankare nuk përputhen sa i përket vlerës së mallit. Nga sistemi cognos dhe asycuda janë hasur të dhëna që dëshmojnë se për mallin e ngjajshëm në periudhën të afërt kohore me cmime më të larta DUD-i R.../21.10.2019. R.../30.09.2019, R.../23.09.2019. Ndër të tjera ka theksuar se për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmojë vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Edhe pse paditësi ka prezentuar gjykatës provat materiale si faturat e mallit, deklaratën e shtetit eksportues, dhe transferet bankare, mirëpo vlera e këtyre pagesave bankare dt.21.05.2019, dt.09.09.2019 të realizuar në Raiffeisen Bank, nuk mund të konstatohet qartë se këto pagesa janë bërë pikërisht për faturat e mallit lëndor të deklaruara me DUD-at kontestuese. Krejt në fund ka konstatuar se nuk ka mundur të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga ajo që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e mjaftueshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor, dhe se aktvendimi me nr.01.3.2.2/11216,13732 i datës 22.10.2019 i Doganës së Kosovës, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Aktgjykimin e ankimuar e ka mbështet në dispozitat e nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitat të këtij aktgjykim.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e pranon edhe kjo gjykatë si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat kanë vërtetuar se pretendimet e paditësit janë të pabazuara. Sepse gjykata e shkallës së parë nga provat që ka paraqit pala paditëse nuk ka qenë e mundur të bëhet harmonizimi i vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksionit të prezantuar sipas transfereve bankare që gjenden në shkresat e lëndës si : transferi bankar i datës 09.09.2019, dhe 21.05.2019. Dokumentacionet përcjellëse të mallit lëndor të paraqitura në dy Deklaratat Unike Doganore R-..../01.08.2019 dhe R-..../16.09.2019 të Zyrës së Brendshme Doganore, nuk harmonizohen në kuptim të vlerës së deklaruar para të paditës dhe gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji i kësaj gjykate, vlerësoi se e paditura, Dogana e Kosovës, me që subjekti nuk ka poseduar dokumentacion adekuat përcjellës të mallit, me të drejtë në procedurë të zhdoganimit është bazuar në të dhënat e disponueshme dhe zhdoganim për mallrat të ngjajshme, si dhe duke u bazuar edhe në importet e mallrave të ngjashme të importuara në priudhën e afërt kohore të siguruara përmes sitemit Cognos dhe Asycuda (R-..../03.06.2019, R-..../21.10.2019,R-..../30.09.2019,R-..../23.09.2019), ka rivlerësuar mallin lëndor, sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, si dhe pretendimet tjera, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
K.DH.SH.II.nr.624/22, me datë 10.11.2022

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri